



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

**KOMUNIKATË PËR SHTYP**

Tiranë, më 10 prill 2015

**Njoftim për kryerje punimesh në segmentin rrugor “Rrethrotullimi i Doganës – Mbikalimi i Kasharit”**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili po kryen punime në segmentin rrugor “Rrethrotullimi i Doganës – Mbikalimi i Kasharit” njofton të gjithë drejtuesit e automjeteve se duke filluar nga data 10.04.2015 deri më 20.04.2015 është parashikuar të kryhen punime për riveshjen me asfalt në drejtimin “Tiranë-Vorë”. Devijimi i trafikut fillon para mbikalimit të Kamzës për në rrugën dytësore, drejtimi Tiranë- Vorë deri tek mbikalimi i Kasharit. Gjatë kësaj periudhe rruga dytësore do të ketë vetëm një kah lëvizje drejtimi “Tiranë-Vorë”. Me qëllim parandalimin e ngjarjeve aksidentale rrugore dhe të garantimit të rrjedhshmërisë së sigurtë për veten dhe për përdoruesit e tjerë të rrugës ju lutemi të gjithë drejtuesve të mjeteve që për arsye nga më të ndryshmet lëvizin në këtë segment, të tregojnë kujdesin maksimal.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Rrugore ka marrë të gjitha masat për lehtësimin e lëvizjes së trafikut gjatë këtyre punimeve.

Nga ana e firmës zbatuese janë marrë të gjitha masat në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për paralajmërimin e vendit të kantierit ku kryhen këto punime, duke vendosur sinjalizimet e duhura për njoftimin dhe marrjen e masave nga ana e drejtuesve të mjeteve. Prej ngushtimeve të domosdoshme të trungut të rrugës në këtë pjesë për krijimin e hapësirës së duhur për realizimin e punimeve, drejtuesit e mjeteve të drejtojnë mjetin me kujdesin maksimal dhe me shpejtësi të moderuar për shmangien e çdo të papriture gjatë kalimit në këtë segment rrugor.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Fondi Shqiptar i Zhvillimit